



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË
NR. 14930/4 VENDIMI

VENDIM

PRISHJE ME NËNVIZIM

Unë gjyqtare Blerina Muça, sot në datë 07.05.2007, mora në shqyrtim kërkesën e:

KËRKUES: **Josif GORREA**, i biri i Vangjelit, dtl. 1965, lindur në Lushnjë, banues në Divjakë, Lushnjë, përfaqësuar me prokurë të posaçme Nr. 2002 rep., Nr. 458kol./1, datë 03.05.2007 nga avokatja Agathi Kukeli, me nr. license 1684.

PALË E TRETË: Stavri Prifti, ekspert kontabël i autorizuar, me nr. license 110, me cilësinë e likuidatorit të shoqërisë “Bruka AB” shpk.

OBJEKTI: Prishjen me nënvizim të veprimeve të likuidatorit në likuidimin e shoqërisë “Bruka AB” shpk.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”.

Pasi dëgjova palën kërkuese në lidhje me shkakun e nisjes së procedurës së prishjes me nënvizim, palën e tretë që ishte dakort me të,

KONSTATOJ

Shoqeri “Buka AB” shpk ka fituar personalitet juridik me Vendimin Nr 14930, datë 20.05.1996 të Gjykates së Rrethit Tiranë, me ortakë Josif Gorreja dhe Nikoll Todi përkatësisht zotërues të 95% dhe 5% të kuotave të kapitalit, me administrator Josif Gorreja, me seli në Divjake, Lushnjë, me

kapital themeltar 100 000 lekë, me objekt veprimtarie tregtim makinerish, farëra, prodhime bujqësore etj. Me vendimin nr. 14930/1, datë 29.05.2002, shoqëria ka pësuar ndryshim duke u bërë ortak i vetëm i saj zoti Josif Gorreja. Nëpërmjet depozitimeve Nr. 2 dhe 3 të akteve të shoqërisë “Bruka AB” shpk rezulton që kjo shoqëri të ketë realizuar procedurat e likuidimit nëpërmjet likuidatorit Stavri Prifti. Zyra e Regjistrimit Tregtar, nëpërmjet vërtetimit të datës 24.04.2007, konfirmon faktin se shoqëria “Bruka AB” shpk është ortakë në shoqërinë “Bruka Seedling” shpk duke zotëruar 52% të kuotave së bashku me shoqërinë hollandeze “Adria Seedling” e cila zotëron 42% të kuotave. Gjithashtu ky vërtetim konfirmon faktin se kjo shoqëri deri në momentin e lëshimit të tij ka vazhduar të ekzistojë. Duke marrë në shqyrtim aktet e depozitimit nr. 14930/3, datë 16.09.2004, kryesisht raportin e likuidimit dhe Vendimin e Ortakut të vetëm të shoqërisë “Bruka AB” shpk, nuk rezulton të jetë trajtuar pjesëmarrja e kësaj shoqërie në shoqërinë “Bruka Seedling” shpk. Kështu në Aktivin e bilancit të likuidimit nuk figuron i pasqyruar zeri përkatës i pjesëmarrjes në shoqëri tjetër, duke mbetur në këtë mënyrë të pambyllura llogaritë e shoqërisë “Bruka AB” shpk për këtë pjesë. Një mangësi e tillë çon domosdoshmërisht në prishjen me nënvizim të depozitimit Nr. 14930/3, datë 16.09.2004, pasi pikërisht mosmarrja parasysh nga likuidatori në momentin e përpilimit të aktit të likuidimit të një pjesë të aktiveve të shoqërisë, përbën mosmbyllje të llogarive të saj dhe për pasojë përbën njëkohësisht mungesë të një kushti thelbësor për likuidimin e një shoqërie. Një fakt tepër i rëndësishëm për këtë përfundim përbën dhe ekzistenca formale e ortakërisë së shoqërisë “Bruka AB” shpk në shoqërinë “Bruka Seedling” shpk, në një kohë që “de jure” shoqëria “Bruka AB” shpk nuk ekziston më që prej vitit 2004. Kjo gjendje e paligjshmërisë së akteve të shoqërive përkatëse do të mund të riparohet vetëm pas përfshirjes nga ana e likuidatorit në aktin e likuidimit edhe të kuotave të zotëruara nga shoqëria “Bruka AB” shpk në shoqërinë “Bruka Seedling” shpk, të cilat do të mund t’i mbeten ortakut të vetëm ose në rast të ekzistencës së detyrimeve kundrejt të tretëve do të shërbejnë për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Nga sa me sipër, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, gjykata e gjen me vend të vendosë prishjen me nënvizim të vendimit Nr. 14930/3, datë 16.09.2004 të gjykatës së rrethit Tiranë, duke qenë tërësisht në kushtet e nenit 19 të Ligjit Nr. 7667, dt.28.01.1993 “Për regjistrin tregtar...”.

PËR KËTO ARSYE

9

Konform nenit 19 e vijues i ligjit 7667, dt.28.011993 “Për regjistrin
tregtar...”

VENDOSA

- Prishjen me nënvizim të vendimit Nr. 14930/3, datë 16.09.2004 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim i veçantë brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë

GJYQTARE
BLERINA MUÇA

